

Ndërsa ceremonitë përkujtimore për 20-vjetorin e masakrës së Srebrenicës zyrtarisht do të mbahen më 11 korrik dhe para tyre në Sarajevë ka nisur “Marshimi i Paqes” në kujtim të viktimave, Allan Little, ish-korrespondent i BBC-së, i cili ka raportuar për krizën dhe konfliktin në ish-Jugosllavi, thotë në një intervistë për “Radion Europa e Lirë” se vrasjet në Srebrenicë kanë qenë të parashikueshme dhe të parandalueshme.

Ku keni qenë në korrik të vitit 1995?

Allan Little: Për fat të keq, në korrik të vitit 1995 kam lënë Bosnjën dhe kam shkuar në Afrikë. Kam qenë me një detyrë në Angola, jam zgjuar në mëngjes dhe kam dëgjuar në BBC se forcat serbe kanë hyrë në Srebrenicë.

E kam ditur menjëherë se kjo do të thotë fillimi i një katastrofe. Kam telefonuar në BBC në Londër dhe u kam thënë se kjo është e tmerrshme, se do të ketë së paku qindra të vrarë në dy-tre ditët e ardhshme dhe se duhet të bëjmë diçka, sepse e dinim modelin, e dinim se çfarë ndodh kur enklavat si Srebrenica bien.

Pikëpamja ime ka qenë se ajo që ka ndodhur në Srebrenicë, ka qenë ndryshe vetëm për nga shkalla e asaj që ka ndodhur për katër vjet jo vetëm në Bosnjë, por edhe në Kroaci. Atë model e kemi parë në Vukovar e tutje, e kemi ditur se do të ndodhin krime masive. Pra, e kemi ditur se çfarë do të ndodhë.

Samantha Power, përfaqësuesja e Shteteve të Bashkuara në OKB, ka qenë gazetare e “Washington Post”-it në atë kohë. Ajo po ashtu ka paraparë masakrën dhe ka raportuar për gazetën e saj. Por, artikulli i saj nuk është publikuar. I është thënë se puna e saj nuk është të parashohë ngjarje, por të raportojë për atë se çfarë ndodh. Nëse gazetari/gazetarja nuk lejohet të alarmojë për një rrezik të ardhshëm, atëherë cili është kuptimi i këtij profesioni?

Allan Little: BBC nuk ka publikuar kurrë as shkrimin tim, për të njëjtat arsye – redaktorët në Londër kanë thënë se nuk është reportazh, por vlerësim i imi. Diçka shumë interesante ka ndodhur atë natë në Kombet e Bashkuara, në prill të vitit 1993. Më kujtohet që kam kaluar gjithë ditën në aeroportin e Sarajevës dhe nuk ka pasur negociata.

Gjenerali Mlladiç është shfaqur me dokumentin për dorëzim dhe ka thënë se nuk ka për çfarë të diskutohet, duhet vetëm të nënshkruhet. Të gjithë e kemi ditur këtë, por zyrtarët e Kombeve të Bashkuara na kanë mbajtur atje me orë të tëra, duke thënë se fakti se dy palët janë ulur rreth së njëjtës tryezë, është shenjë e përparimit.

Nuk ka qenë e vërtetë. Ata vetëm kanë luajtur me kohën dhe kanë pritur që të ndodhë diçka në Nju Jork.

Kur na kanë dërguar në qytet, sepse nuk kemi pasur për çfarë të raportojmë, na kanë thënë se do të na informojnë sa të nënshkruhet marrëveshja. Jemi informuar në orën 5 të mëngjesit të ardhshëm. Jam zgjuar nga thirrja telefonike e zëdhënësit të Kombeve të Bashkuara në Sarajevë, i cili ka thënë: ‘Kemi marrëveshje’ dhe ka treguar se për çfarë bëhet fjalë.

Rreth orës 6:00 kam thirrur redaksinë time për t’i treguar se është nënshkruar marrëveshja për

Srebrenicën. Redaktori më ka thënë se ka kohë që e di, se e ka marrë informacionin nga Nju Jorku qysh nga mbrëmja e kaluar.

Ata qëllimisht i kanë fshehur informacionet nga korrespondentët në Sarajevë, sepse e kanë ditur se ne e dimë se për çfarë bëhet fjalë. I kanë plasuar informacionet në Nju Jork dhe neve nuk na kanë informuar.

I kanë plasuar përmes korrespondentëve të Kombeve të Bashkuara, sepse e kanë ditur se ata do të bindin botën se bëhet fjalë për marrëveshje të çarmatimit, me të cilën të gjithë janë të kënaqur. Mirëpo, ne e kemi ditur se nuk bëhet fjalë për marrëveshje të çarmatimit, por të dorëzimit, dhe e kemi ditur se e gjithë kjo është shumë e rrezikshme.

Kjo rezolutë, në fakt, ka qenë parahyrje e asaj që ka ndodhur në korrik të vitit 1995...

Allan Little: Po. Dhe, e kemi ditur se kjo është e vërtetë. E kemi ditur me kohë se kjo është parahyrje për një masakër. E kemi ditur me kohë se ajo e lë popullin e Srebrenicës të ekspozuar ndaj hakmarrjes së atyre që kanë rrethuar enklavën për një vit. E kemi ditur në prill të vitit 1993 se kjo ka qenë recetë për vrasje masive.

Presidenti i Serbisë, Tomislav Nikolić, nuk do të shkojë në Srebrenicë për përvjetorin e masakrës. Rusia ka sfiduar rezolutën e hartuar nga Britania që e cilëson masakrën si gjenocid. Edhe sa kohë do ta ndikojnë situatën në Bosnjë këto ngjarje?

Allan Little: Një nga pengesat e mëdha për çdo lëvizje përpara në Bosnjë është refuzimi i vazhdueshëm i Republikës së Serbisë për të njohur natyrën e asaj që ka ndodhur. Serbia nuk ka ende president ose kryeministër që mund të përballet me realitetin. /gazetashqip/